



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Gjilanit



Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028

Gjilan 2025

Përmbajtja

I. Hyrje

II. Deklarata e komunës se Gjilanit në lidhje me prioritetet strategjike zhvillimore

III. Korniza Fiskale

3.1 Korniza makroekonomike komunale

3.2 Tendenca e të hyrave komunale dhe parashikimet 2026-2028

3.3 Tendenca e shpenzimeve komunale dhe parashikimet 2026-2028

3.4 Donatorët e jashtëm

3.5 Politikat e reja

I. Hyrje

Dokumenti i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB), është një dokument i cili miratohet në parim për çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme për të hyrat dhe shpenzimet publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor. Gjithashtu KAB, siguron mekanizmat e nevojshme, përmes të cilave, objektivat prioritare, të identifikuar në dokumentet strategjike të komunës, aty ku ekzistojnë, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor.

Hartimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore përbën një detyrim ligjor për institucionet buxhetore komunale të kërkuar me Qarkore Buxhetore Komunale 2026/01 dhe Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2025-2027 e lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) {Pasi ende nuk është aprovuar Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) për vitet 2026-2028 }.

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritarë të zhvillimit dhe identifikimin e prioriteteve të shpërndarjes së resurseve komunale për periudhën 2026-2028. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB Komunale dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtë:



Komuna ka filluar ciklin buxhetor me shqyrtimin e prioriteteve nga viti paraprak, duke bërë një analizë të hyrave dhe shpenzimeve të planifikuara dhe realizuara. Dokumenti është ndarë me të gjithë drejtoritë/sectorët si kontribut për ciklin vijues buxhetor.

Ne fazën e dytë drejtoritë komunale janë mbledhur dhe kanë diskutuar prioritetet dhe kërkesat e tyre buxhetore si dhe të hyrat komunale për drejtoritë që realizojnë të hyra. Drejtoritë e komunës kanë filluar me plotësimin e formularëve për shpenzime dhe të hyra për periudhën afatmesme buxhetore pasi kanë pranuar qarkoren e brendshme buxhetore me kufijtë buxhetor të përcaktuar dhe shpalosur në qarkoren e parë buxhetore që ka lëshuar Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Takime konsultuese janë mbajtur me drejtori të caktuara sipas kërkesave dhe nevojës deri në takimin e radhës kur kërkesat buxhetore dhe të hyrat për periudhën afatmesme janë vendosur. Drejtoria për buxhet dhe financa në bazë të kërkesave të pranura buxhetore të njëjtat l ka shqyrtuar duke u bazuar në planin e të hyrave ka përpiluar dokumentin në vijim, i cili do t'i dorëzohet Asamblesë komunale për shqyrtim dhe së fundi Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

II. Deklarata e Komunës në lidhje me prioritetet strategjike zhvillimore duke përfshirë edhe perspektivën gjinore

Komuna e Gjilanit gjendet në pjesën juglindore të Kosovës, rajoni i Anamoravës. Është njëra nga komunat e mëdha të vendit. Pozita gjeografike që ka, i mundëson asaj lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit. Komuna e Gjilanit ka gjithsej 42 fshatra. Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë të vitit 2024, Komuna e Gjilanit ka 82980 banorë të organizuar në 19871 ekonomi familjare. Prej tyre 41764 meshkuj ndërsa 41216 femra. Kjo përkatësi gjinore mund të shprehet edhe në bazë të vendbanimeve e cila është si në vijim: Urbane 53279 banorë prej tyre 26602 meshkuj dhe 26677 femra. Ndërsa rurale: 29701 banorë prej tyre 15162 meshkuj dhe 14539 femra

Mbi 6608 biznese operojnë brenda Komunës Gjilanit. Bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, 1782(26%) e bizneseve merren me veprimtari tregtare, 3321(50,30%) e bizneseve në sektorin e shërbimeve, afërsisht 988 (15,00%) e bizneseve në prodhimtari dhe 517(7,80%) e bizneseve merret me ndërtimtari.

Prej këtyre bizneseve 5521(83,60%) udhëheqen nga meshkujt, 1087 (16.40%) biznese udhëheqen nga femrat

Vizioni i mëposhtëm për Komunën bazohet në dokumentet afatmesme dhe afatgjata strategjike, siç janë: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) 2025-2027 të Qeverisë së Kosovës, Qarkorja Buxhetore Komunale 2026-2028, e lëshuar nga MFPT e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Vizioni i Komunës së Gjilanit për tri vitet e ardhshme është zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, me urbanizëm modern dhe shërbime efikase e kualitative, i integruar në proceset rajonale dhe ndërkombëtare, si një qendër e kulturës së pasur, arsimimit dhe jetës sportive, me shërbime financiare të digjitalizuara dhe ofrimi i një kualiteti të mirë të jetesës për qytetarët e saj duke përfshirë edhe barazinë gjinore.

Atributet më të rëndësishme të çfarëdo dokumenti të planifikimit strategjik dhe vizionit të definuar janë komunikimi dhe llogaridhënia. Komuna e Gjilanit vazhdon të punojë në drejtim të këtyre attribute binjake, përmes prioritetëve strategjike të Komunës, për periudhën afatmesme.

Komuna vazhdon të punojë në katër prioritetet strategjike të përcaktuara nga vitet e kaluara:

I. Forcimi i Ekonomisë Komunale me mundësi për të gjithë

Rritja e ekonomisë komunale përmes:

Avancimi i i i standardeve të arsimimit dhe nivelit të arritjes (pajisje shkollore, renovime shkollore dhe përmirësim, bursa për studime, laboratorë)

Gjatë vitit 2024 janë ndarë 291 bursa për studentë ku përfitues në aspektin gjinorë kanë qenë 68 meshkuj (23.37%) dhe 223 femra (76.63%).

Mbështetje direkte sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë .Në vitet e kaluara duke u bazuar në statistikat që posedon komuna përkatësia gjinore e përfituesve nga mbështetja direkte është si në vijim e shprehur në përqindje: 61% meshkuj, 39% femra.

2. Avancimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve

Ofrimi i shërbimeve për qytetarët për të pasur jetë të shëndetshme dhe aktive në komunitetin e tyre:

Asistenca sociale për familjet në nevojë, pa të ardhura apo të ardhura të ulëta si dhe për nenat-vetë ushqyese.

Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ofrimi i shëndetësisë mobile

Shërbimet e shëndetësisë mobile për vitin 2024 janë gjithsej 11966, prej tyre 6228 femra (52.08%) dhe 25736 meshkuj (47.95%),

Promovimi i projekteve për rini, kulturë, dhe sport (ofrimi i terreneve të reja sportive). Janë ndërtuar fusha të sportit nëpër fshatra, terrene sportive në shkolla. Paraprakisht janë konsultuar përkatësit e dy gjinive.

3. Përmirësimi i ambientit të Komunës dhe qëndrueshmëria e tij

- Përmirësimi dhe rigjenerimi i infrastrukturës rrugore (sinjalizimi horizontal e vertikal, ndriçimi publik dhe numerizimi; transportit; ujësjellës dhe kanalizime
- Përmirësimi i standardeve ambientale
- Ofrimi i më shumë hapësirave të gjelbëruara

Ndërsa prioriteti i katërt strategjik ka të bëjë me efikasitetin e brendshëm të qeverisë komunale dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët e saj.

4. Krijimi i qeverisë komunale që ofron shërbime efikase dhe që u përgjigjet kërkesave të qytetarëve

Përmirësimi i shërbimeve komunale karshi qytetarëve duke u fokusuar në ofrimin e shërbimeve të shpejta dhe efikase:

Katër fushat prioritare të komunës dhe objektivat e saj për periudhën afatmesme 2026-2028 do të shoqërohen me një mikës të hyrash dhe shpenzimesh në të pesë kategoritë ekonomike të cilat do të mund të monitorohen dhe raportohen karshi arritjeve.

III. Korniza Fiskale Komunale

3.1 Ndonëse komuna nuk udhëheqë drejtpërdrejt politikën makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore) mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyrën fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën më poshtë. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit Korniza Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2025-2027 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Komponentët e politikës makroekonomike siç janë Bruto Produkti Vendor, inflacioni dhe demografia duhet konsideruar dhe marrë parasysh duke u bazuar edhe në përkatësinë gjinore. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2025-2027 e Qeverisë së Kosovës bazuar në të dhënat historike si dhe në zhvillimet e fundit ekonomike,

nënvizon faktin se do të ketë ecuri pozitive të rritjes ekonomike në vitet e ardhshme, më saktësisht në periudhën 2025-2027. Parashihet rritje ekonomike prej 4,20% në vitin 2025, 4,20% në vitin 2026 dhe 4,10% në vitin 2027.

Natyrisht se rritja ekonomike ndryshe përkthehet edhe në krijimin e vendeve të reja të punës dhe zbutjen e papunësisë në Komunë, që në periudhën afatmesme ulet me 3%, nga niveli i përgjithshëm i papunësisë që llogaritet të jetë i lartë.

Komuna nga ana e saj do të adaptojë legjislacionin përkatës në funksion të krijimit të ambientit më të mirë për sektorin privat dhe rritjes së të ardhurave të tyre, rrjedhimisht rritjes së të hyrave buxhetore komunale.

Tabela 1: Indikatorët Ekonomik Komunal

Përshkrimi	2025	2026	2027 (vlerësim)	2028(vlerësim)
Indikatorët makroekonomik në Kosovë				
Rritja reale e BPV në % ^{*1}	4.20	4.20	4.10	
Inflacioni në %	2.20	2.20	2.00	
Indikatorët ekonomik komunal				
Popullsia e Komunës	82980	82980	82980	82980
Numri i bizneseve	6608	6700	6800	6900
Numri i nxënësve	15711	15600	15500	15400

3.2 Tendencat e të hyrave komunale dhe parashikimi afat-mesëm 2026-2028

Të hyrat e Komunës së Gjilanit – grantet qeveritare, të planifikuara për periudhën e ardhshme afatmesme, do të kenë shumë ndryshime nga viti në vitë, ku granti i përgjithshëm që do të shënojë një rritje prej 12.41% në vitin 2026 krahasuar me vitin 2025, granti i shëndetësisë do të ketë një rritje prej 0,22% në vitin 2026, granti i arsimit një rritje prej 2,27% , financimi i teatrove rritje 17,44% dhe financimi për shërbime residenciale 98,36%.Ndërsa plani për të hyrat vetanake komunale ka rënie 5,15% krahasuar me periudhën e kaluar 2025.

¹ Burimi: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve, Qeveria e Kosovës, 2025-2027 faqe 32

Tabela 2: Krahاسimi i Buxhetit sipas Burimeve të Financimit

KUFIJT BUXHETORE


Përshkrimet	2025	2026	2027	2028
Granti i përgjithëshem	14,597,113.00	16,408,177.00	17,677,278.00	19,100,845.00
Granti i Shëndetsisë	4,307,553.00	4,317,011.00	4,446,521.00	4,579,917.00
Granti i Arsimit	14,415,178.00	14,741,775.00	15,184,028.00	15,639,549.00
Te hyrat vetanake	6,137,220.00	5,821,202.00	6,260,365.00	6,290,699.00
Financimi I teatrove	288,016.00	338,259.00	356,864.00	376,491.00
Financimi për shërbime rezidenciale	152,500.00	302,500.00	415,000.00	415,000.00
Totali €	39,897,580.00	41,928,924.00	44,340,056.00	46,402,501.00

3.2.1 Të hyrat vetanake komunale

Nga të hyrat tatimore komuna inkason vetëm tatimin në pronë, ndërsa të gjitha te hyrat tjera i përkasin të hyrave jo tatimore, kryesisht taksa në shërbime dhe ngarkesa të ndryshme, të cilat përcaktohen përmes një rregullore që komuna nxjerrë çdo vitë. Përcaktimi i kostos për taksat dhe ngarkesat bëhet në masën që mbulon koston e ofrimit të shërbimit të caktuar. **Në planifikimin e të hyrave të viteve 2026-2028 nuk janë të planifikuara te hyrat indirekte (Gjobat e trafikut, Gjobat e gjykatave dhe të hyrat e APK) pasi kjo është kërkuar me vendim nga Ministri i Financave nr.01-813 date 22.05.2019.**

Tabela 3: Planifikimi i Të hyrave Vetanake

Përshkrimi	Realizimi 2024	Planifikimi 2025	Planifikimi 2026	Vlersimi I hershëm 2027	Vlersimi I hershëm 2028
Të hyrat nga DAP	146,581.00	100,000.00	80,000.00	80,000.00	80,000.00
Të hyrat nga Qiraja	99,994.66	130,000.00	130,000.00	130,000.00	130,000.00
Të hyrat nga zhvillimi ekonomik	4,979.06	70,000.00	30,000.00	40,000.00	50,000.00
Të hyrat nga Urbanizmi, planifikimi dhe mbrojtja e mjedisit	1,293,887.49	1,650,000.00	1,123,581.00	1,200,074.00	1,133,074.00
Të hyrat nga shërbimet publike	111,613.92	130,000.00	120,000.00	120,000.00	120,000.00
Të hyrat nga Gjeodezia	263,546.00	280,000.00	250,000.00	250,000.00	250,000.00
Të hyrat e kultures	14,671.60	20,000.00	20,000.00	20,000.00	20,000.00
Te hyrat e Teatrit		10,000.00	15,000.00	15,000.00	16,000.00
Të hyrat nga regjistrimi I automjeteve	259,230.00	280,000.00	260,000.00	270,000.00	270,000.00
Të hyrat nga tatimi në Pronë	1,621,281.26	2,282,571.00	2,504,879.00	2,686,482.00	2,713,347.00
Tatimi në tokë		490,253.00	573,396.00	693,809.00	697,278.00
Të hyrat e bujqesis	87,222.75	75,000.00	75,000.00	75,000.00	75,000.00
Të hyrat nga Arsimi	246,913.90	340,000.00	350,000.00	360,000.00	400,000.00
Të hyrat nga Shëndetsia	174,825.40	200,000.00	210,000.00	220,000.00	230,000.00
Të Hyrat e QPS	50.00	50.00			
Të Hyrat nga inspekcioni	36,757.60	79,346.00	79,346.00	100,000.00	106,000.00
Të Hyrat e Koncesion	2,313.92				
Kthim I mjeteve	340.00				
Të hyrat komunale direkte	4,364,208.56	6,137,220.00	5,821,202.00	6,260,365.00	6,290,699.00
Gjobat në trafik	1,139,099.50				
Gjobat e gjykatave	87,679.00				
Të hyrat e bujqesis-A.P.K	28,869.36				
Të hyrat komunale indirekte	1,255,647.86	-	-	-	-
Të hyrat komunale direkte dhe indirekte	5,619,856.42	6,137,220.00	5,821,202.00	6,260,365.00	6,290,699.00



3.3 Donatorët e jashtëm (ndërkombëtarë) dhe të brendshëm Vlera totale e financimit të donatorëve të jashtëm, dhe participimet nga qytetarët kryesisht, në realizimin e projekteve të ndryshme për Komunën, gjatë vitit 2024 është 53.530,70€ (sipas tabelës më poshtë) që ndryshe prezanton 0,13% të buxhetit total të Komunës

Tabela 4: Financimi nga Donatorët 2024

Participime	19,346.74
Grande tjera të jashtme	12,421.06
Save the Children	1,611.94
Qeveria Daneze	0.02
EU -Unioni European	16,609.34
UNDP	3,311.60
Greqia	230.00
Gjithësejt:	53.530,70


Komuna nuk ka të planifikuar donacione të jashtme për periudhën e ardhshme afatmesme meqë nuk ka marrëveshje të nënshkruar me ta eventualisht zotime paraprake.

3.4 Tendanca e shpenzimeve komunale 2025-2028 dhe parashikimi afat-mesëm i tyre

Shpenzimet komunal0e në periudhën e ardhshme afatmesme kanë tendence rritje, që siç shihet në grafikonin në vijim:

Përshkrimet	2025	2026	2027	2028
Pagat dhe medijtjet	20,688,947.00	23,387,898.00	23,612,911.00	23,782,665.00
Mallrat dhe sherbimet	7,777,357.00	8,953,332.00	9,593,008.00	9,930,719.00
Shpenzimet komunale	628,700.00	683,700.00	720,171.00	751,632.00
Subvencione	1,998,279.00	2,238,727.00	2,399,714.00	2,195,265.00
Shpenzime Kapitale	8,804,294.00	6,665,267.00	8,014,252.00	9,742,220.00
Totali €	39,897,577.00	41,928,924.00	44,340,056.00	46,402,501.00

Grafikoni : Tendanca e Shpenzimeve Agregate 2025-2028



Pagat dhe mëditjet: Duke krahasuar vitin 2025 me vitin 2026 kjo kategori e shpenzimeve pritet të rritet rreth 13,05% bazuar në Ligjin e ri te pagave për sektorin publik.Kjo kategori në Komunën e Gjilanit përfaqëson pjesën më të madhe të shpenzimeve totale të Komunës nga 55,78% sa janë të buxhetuara në 2026 në 53.25% që parashihen me vlerësimet e hershme të kësaj kornize në vitin 2027 dhe 51,25% vitin 2028. Një zvogëlim i tillë është si rezultat i parashikimeve pozitive ekonomike që ka ndikuar në rritjen e kategorive tjera ekonomike, e posaçërisht në shpenzimet kapitale. Trendi i pagave, sipas marrëveshjes me Fondin Monetar Nderkombetar dhe resurseve në dispozicion do të jetë në harmoni me zhvillimin e gjithëmbarshtëm ekonomik në vend. Sfide do të mbetet trajtimi i politikave të reja me ndikim në këtë kategori sigurimi shëndetësor.

Mallrat dhe shërbimet: Kjo kategori e shpenzimeve në vitin 2026 pritet të ketë rritje 15,12 % krahasuar me vitin 2025. Në përgjithësi pjesëmarrja e shpenzimeve për mallra dhe shërbime në totalin e shpenzimeve pritet të jete 21.35% në vitin 2026 .

Shpenzimet komunale: Kjo kategori e shpenzimeve në vitin 2026 krahasuar me vitin 2025 pritet të ketë një rritje prej 8,75% në totalin e shpenzimeve pritet të jete 1.63% në vitin 2026.

Subvencione dhe transfere Pjesëmarrja e shpenzimeve në vitin 2026 është 5,34%, 2027 – 5,41 %, dhe 2028 – 4,73%. Nga kjo ngritje do të përkrahet sektori i bujqësisë, shpenzimet e varrimit,fasadimin e banesave, shëndetësi – mirëqenie sociale, kulturë, rini, sport, si dhe në sektorin e arsimit nxënësve dhe studentëve. Trendi i subvencioneve gjatë periudhës afatmesme pritet të mbetet konstant pa ndryshime të theksuara.


Përshkrimi i subvencioneve për bujqësi:

Emërtimi	2026	2027	2028	Përshkrimi
Furnizimi me farë misri dhe plehë mineral	53,000.00	53,000.00	64,000.00	Rritja e sipërfaqeve të mbjellura me misër, duke i pasur në target fermerët që nuk subvencionohen nga MBPZHR.
Serra komerciale	40,000.00	61,000.00	62,000.00	Rritja e rendimentit të perimeve dhe furnizimi i vazhdueshëm i tregut me perime të freskëta.
Mekanizim Bujqësor	53,000.00	73,000.00	80,000.00	Me Mekanizimi bujqësor synojmë rritjen e rendimentit për njësi të sipërfaqes dhe uljen e kostos së prodhimit
Furnizim me shtëpiza për bletë	27,000.00	27,000.00	32,000.00	Me furnizim me shtëpiza për bletë synojmë ngritjen e kapaciteteve të reja
Furnizimi me farë gruri dhe pleh mineral	66,000.00	116,000.00	120,000.00	Rritja e sipërfaqeve të mbjellura me grurë dhe në fokus janë fermerët që nuk i arrijnë kriteret për subvencionim nga MBPZHR.
Furnizim me fidane të arrës	20,000.00	20,000.00	25,000.00	Kultivimi i arrës ka zgjuar interesim të madh te fermerët për shkak përfitimit të madh dhe kërkesave të mëdha të tregut
Subvencionimi qumështië I	41,000.00	50,000.00	67,000.00	Stimulimi I fermereve për rritjen e kapacitetit të qumështitë
Gjithësejt	300,000.00	400,000.00	450,000.00	

Shpenzime Kapitale: Kjo kategori e shpenzimeve në vitin 2026 pritet të jenë 15,90%, në vitin 2027- 18,07% dhe në vitin 2028 – 21,00%.

Shpenzimet sipas Sektorëve në vitin 2026

Grafikoni në vijim paraqet vlerësimin e ndarjeve sipas sektorëve / drejtorive në % të planifikimit vitit 2026.



Sipas këtyre vlerësimeve, pjesa më e madhe e shpenzimeve të komunës për vitin 2026 dhe tutje ndahet për sektorin e arsimit parauniversitar që në total përbëjnë 49,64% të buxhetit. Pjesa tjetër e resurseve është e ndarë

për Shërbime Publike, Infrastrukturë dhe Banim, Zhvillim Ekonomik, Kadastër Gjeodezi dhe Pronë, Urbanizëm, Kulturë, Rini dhe Sport, Shëndetësisë primare. Pjesa e mbetur ndahet për shërbimet mbështetëse .

Tabela në vijim është një pasqyrë e shpërndarjes së shpenzimeve komunale në bazë të programeve të komunës dhe në bazë të kategorive ekonomike si në vijim:

Shpenzimet Janar Dhjetor 2024 (nga grantet, të hyrat vetanake dhe të bartura)								
Drejtoritë/Programet	Drejtoritë/ Programet	Numri i puntoreve	Pagat	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione	Shpenzime kapitale	Gjithësej €
Zyra e Kryetari	160/16027		245,538.79	137,850.03	8,500.00	56,483.29	-	448,372.11
Administrata e përgjithëshme	163/16327		237,286.23	307,628.23	23,930.79	-	19,700.00	588,545.25
Inspekcioni	166/16653		123,218.48	139,903.09	10,534.05	-	-	273,655.62
Prokurimi	167/16835		72,845.01	7,813.40	898.83	-	-	81,557.24
Zyra e Kuvendit komunal	169/16927		275,940.77	34,500.90	-	-	-	310,441.67
Buxhet dhe financa	175/17527		185,180.10	59,470.54	12,999.65	-	-	257,650.29
Shërbime Publike,Infrastrukturë dhe banim	180/18187		111,366.38	1,311,643.45	221,112.66	228,268.84	5,114,793.39	6,987,184.72
Mbrojtje dhe Shpëtim	180/18431		326,134.13	162,039.80	8,782.27	-	92,695.94	589,652.14
Zyra e komuniteteve	195/19635		45,617.13	5,897.14	2,000.00	-	-	53,514.27
Bujqësi dhe Pylltari	470/47027		68,310.11	89,859.36	6,913.84	309,327.61	235,384.00	709,794.92
Zhvillim Ekonomik	480/48027		104,308.78	110,152.63	1,997.18	126,512.95	1,323,829.91	1,666,801.45
Kadastër ,Gjeodezi ,Pronë	650/65335		157,544.65	31,958.12	7,770.79	-	530,746.27	728,019.83
Urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit	660/66440		168,874.72	327,940.61	7,372.26	-	136,213.09	640,400.68
Shëndetësia	730	0	3,169,221.12	780,504.63	118,060.13	292,780.00	248,666.07	4,609,231.95
DSHMS	730/73036		38,607.33	75,012.55	10,163.00	292,780.00	-	416,562.88
QKMF	730/74600		3,130,613.79	705,492.08	107,897.13	-	248,666.07	4,192,669.07
QPS	755/75631		92,470.80	22,268.26	5,190.59	-	-	119,929.65
Sherbimet Rezidenciale	755/75632		-	45,000.00	5,000.00	-	280,000.00	330,000.00
Kulturë, Rini dhe Sport	850/85027		197,979.92	138,240.80	38,393.86	330,000.00	-	704,614.58
Teatri	850/85208		257,899.98	99,498.01	6,928.78	33,142.20	-	397,468.97
Arsim dhe shkencë	920	0	16,074,168.71	2,939,400.38	190,831.86	69,050.00	482,306.94	19,755,757.89
DKA	920/92135		127,706.87	1,473,155.11	9,726.25	69,050.00	482,306.94	2,161,945.17
Arsimi parashkollor dhe qerdhet	920/92730		810,539.24	312,405.27	32,705.04	-	-	1,155,649.55
Arsimi fillor	920/93780		12,023,852.85	742,057.74	104,498.27	-	-	12,870,408.86
Arsimi I mesem	920/94980		3,112,069.75	411,782.26	43,902.30	-	-	3,567,754.31
Gjithësej €		0	21,913,905.81	6,751,569.38	677,217.54	1,445,564.89	8,464,335.61	39,252,593.23

Planifikimi 2025

Drejtoritë/Programet	Drejtoritë/ Programet	Numri i puntoreve	Pagat	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione	Shpenzime kapitale	Gjithësejt €
Zyra e Kryetari	160/16027	32	293,746.00	100,000.00	7,000.00	60,000.00		460,746.00
Administrata e përgjithëshme	163/16327	43	294,443.00	350,000.00	20,000.00		10,000.00	674,443.00
Inspekcioni	166/16653	18	170,278.00	100,000.00	8,000.00			278,278.00
Prokurimi	167/16835	12	102,051.00	10,000.00	500.00			112,551.00
Zyra e Kuvendit komunal	169/16927	35	321,542.00	25,000.00				346,542.00
Buxhet dhe financa	175/17527	30	244,872.00	60,000.00	7,000.00			311,872.00
Shërbime Publike,Infrastrukturë dhe banim	180/18187	13	120,574.00	1,600,000.00	220,000.00	250,000.00	4,710,000.00	6,900,574.00
Mbrojtje dhe Shpëtim	180/18431	42	350,288.00	212,000.00	6,000.00		140,000.00	708,288.00
Zyra e komuniteteve	195/19635	7	53,044.00	2,000.00	500.00	5000		60,544.00
Bujqësi dhe Pylltari	470/47027	8	74,890.00	90,000.00	6,000.00	300,000.00	380,000.00	850,890.00
Zhvillim Ekonomik	480/48027	13	115,216.00	50,000.00	2,000.00	150,000.00	1,601,986.00	1,919,202.00
Kadastër ,Gjeodezi ,Pronë	650/65335	26	208,670.00	32,000.00	7,000.00		285,501.00	533,171.00
Urbanizëm, planifikim dhe mbrojtje të mjedisit	660/66440	20	179,858.00	350,000.00	11,000.00		600,000.00	1,140,858.00
Shëndetësia	730	293	3,398,578.00	1,124,846.00	91,500.00	521,939.00	446,307.00	5,583,170.00
DSHMS	730/73036	6	47,646.00	75,000.00	5,100.00	521,939.00	300,000.00	949,685.00
QKMF	730/74600	287	3,350,932.00	1,049,846.00	86,400.00		146,307.00	4,633,485.00
QPS	755/75631	16	127,327.00	36,000.00	3,200.00			166,527.00
Shërbimet residenciale	755/75632	10	52,500.00	45,000.00	5,000.00		280,000.00	382,500.00
Kulturë, Rini dhe Sport	850/85027	31	228,290.00	134,511.00	45,000.00	317,000.00	80,000.00	804,801.00
Teatri I Gjilanit	850/85208	22	248,269.00	150,000.00	6,000.00	31,340.00		435,609.00
Arsim dhe shkencë	920	1,748	14,104,511.00	3,306,000.00	183,000.00	363,000.00	270,500.00	18,227,011.00
DKA	920/92135	19	155,619.00	1,650,000.00	4,000.00	363,000.00	270,500.00	2,443,119.00
Arsimi parashkollor dhe qerdhet	920/92730	147	1,036,667.00	318,000.00	35,000.00			1,389,667.00
Arsimi fillor	920/93780	1174	9,539,111.00	783,000.00	94,000.00			10,416,111.00
Arsimi I mesem	920/94980	408	3,373,114.00	555,000.00	50,000.00			3,978,114.00
Gjithësejt €		2,419	20,688,947.00	7,777,357.00	628,700.00	1,998,279.00	8,804,294.00	39,897,577.00

Planifikimi 2026

Drejtoritë/Programet	Drejtoritë/ Programet	Numri i puntoreve	Pagat	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione	Shpenzime kapitale	Gjithësejt €
Zyra e Kryetari	160/16027	32	335,161.00	180,000.00	6,500.00	75,000.00		596,661.00
Administrata e përgjithëshme	163/16327	43	349,456.00	400,000.00	25,000.00			774,456.00
Inspekcioni	166/16653	18	192,653.00	140,000.00	8,000.00			340,653.00
Prokurimi	167/16835	12	112,206.00	10,000.00	500.00			122,706.00
Zyra e Kuvendit komunal	169/16927	35	333,113.00	30,000.00				363,113.00
Buxhet dhe financa	175/17527	30	273,610.00	70,000.00	6,000.00			349,610.00
Shërbime Publike,Infrastrukturë dhe banim	180/18187	13	132,802.00	2,000,000.00	250,000.00	415,000.00	2,105,267.00	4,903,069.00
Mbrojtje dhe Shpëtim	180/18431	42	405,554.00	215,000.00	8,000.00	60,000.00	-	688,554.00
Zyra e komuniteteve	195/19635	7	62,352.00	5,500.00	1,000.00			68,852.00
Bujqësi dhe Pylltari	470/47027	8	82,366.00	90,000.00	6,000.00	300,000.00	160,000.00	638,366.00
Zhvillim Ekonomik	480/48027	13	127,968.00	200,000.00	2,000.00	250,000.00	3,000,000.00	3,579,968.00
Kadastër ,Gjeodezi ,Pronë	650/65335	26	238,305.00	33,000.00	7,000.00		500,000.00	778,305.00
Urbanizëm, planifikim dhe mbrojtje të mjedisit	660/66440	20	206,514.00	450,000.00	11,000.00		300,000.00	967,514.00
Shëndetësia	730	301	3,509,633.00	1,061,473.00	91,500.00	521,939.00	-	5,184,545.00
DSHMS	730/73036	6	55,495.00	75,000.00	5,100.00	521,939.00		657,534.00
QKMF	730/74600	295	3,454,138.00	986,473.00	86,400.00			4,527,011.00
QPS	755/75631	16	143,220.00	36,000.00	3,200.00			182,420.00
Shërbimet residenciale	755/75632	10	102,500.00	90,000.00	10,000.00		100,000.00	302,500.00
Kulturë, Rini dhe Sport	850/85027	31	268,969.00	141,359.00	50,000.00	317,000.00		777,328.00
Teatri I Gjiçanit	850/85208	22	288,471.00	150,000.00	10,000.00	49,788.00		498,259.00
Arsim dhe shkencë	920	1,723	16,223,045.00	3,651,000.00	188,000.00	250,000.00	500,000.00	20,812,045.00
DKA	920/92135	19	169,327.00	2,000,000.00	4,000.00	250,000.00	500,000.00	2,923,327.00
Arsimi parashkollor dhe qerdhet	920/92730	147	1,220,341.00	318,000.00	35,000.00			1,573,341.00
Arsimi fillor	920/93780	1165	11,071,413.00	778,000.00	99,000.00			11,948,413.00
Arsimi I mesem	920/94980	392	3,761,964.00	555,000.00	50,000.00			4,366,964.00
Gjithësejt €		2,402	23,387,898.00	8,953,332.00	683,700.00	2,238,727.00	6,665,267.00	41,928,924.00

Vlersimi I hershëm 2027

Drejtoritë/Programet	Drejtoritë/ Programet	Numri i puntoreve	Pagat	Mallra dhe sherbime	Shpenzime komunale	Subvencione	Shpenzime kapitale	Gjithësejt €
Zyra e Kryetari	160/16027	32	336,837.00	190,000.00	6,000.00	80,000.00		612,837.00
Administrata e përgjithëshme	163/16327	43	351,204.00	410,000.00	25,000.00			786,204.00
Inspekcioni	166/16653	18	193,616.00	160,000.00	8,500.00			362,116.00
Prokurimi	167/16835	12	112,767.00	10,000.00	500.00			123,267.00
Zyra e Kuvendit komunal	169/16927	35	334,778.00	32,000.00				366,778.00
Buxhet dhe financa	175/17527	30	274,978.00	73,000.00	6,000.00			353,978.00
Shërbime Publike,Infrastrukturë dhe banim	180/18187	13	133,466.00	2,200,000.00	260,000.00	415,000.00	1,920,000.00	4,928,466.00
Mbrojtje dhe Shpëtim	180/18431	42	407,581.00	230,000.00	8,300.00		100,000.00	745,881.00
Zyra e komuniteteve	195/19635	7	62,663.00	5,600.00	1,000.00			69,263.00
Bujqësi dhe Pylltari	470/47027	8	82,777.00	100,000.00	6,000.00	400,000.00	295,000.00	883,777.00
Zhvillim Ekonomik	480/48027	13	128,608.00	250,000.00	2,000.00	250,000.00	3,936,752.00	4,567,360.00
Kadastër ,Gjeodezi ,Pronë	650/65335	26	239,496.00	33,000.00	7,000.00		600,000.00	879,496.00
Urbanizëm, planifikim dhe mbrojtje të mjedisit	660/66440	20	207,546.00	550,000.00	12,000.00		650,000.00	1,419,546.00
Shëndetësia	730	301	3,635,772.00	1,066,521.00	100,100.00	521,939.00	-	5,324,332.00
DSHMS	730/73036	6	55,772.00	75,000.00	5,100.00	521,939.00		657,811.00
QKMF	730/74600	295	3,580,000.00	991,521.00	95,000.00			4,666,521.00
QPS	755/75631	16	143,935.00	36,000.00	3,200.00			183,135.00
Shërbimet residenciale	755/75632	10	102,500.00	90,000.00	10,000.00		212,500.00	415,000.00
Kulturë, Rini dhe Sport	850/85027	31	270,313.00	150,000.00	55,000.00	330,000.00		805,313.00
Teatri I Gjilanit	850/85208	22	289,914.00	170,000.00	12,000.00	52,775.00		524,689.00
Arsim dhe shkencë	920	1,723	16,304,160.00	3,836,887.00	197,571.00	350,000.00	300,000.00	20,988,618.00
DKA	920/92135	19	170,174.00	2,101,828.00	4,204.00	350,000.00	300,000.00	2,926,206.00
Arsimi parashkollor dhe qerdhet	920/92730	147	1,226,442.00	334,190.00	36,782.00			1,597,414.00
Arsimi fillor	920/93780	1165	11,126,770.00	817,611.00	104,040.00			12,048,421.00
Arsimi I mesem	920/94980	392	3,780,774.00	583,258.00	52,545.00			4,416,577.00
Gjithësejt €		2,402	23,612,911.00	9,593,008.00	720,171.00	2,399,714.00	8,014,252.00	44,340,056.00

Vlersimi I hershëm 2028

Drejtoritë/Programet	Drejtoritë/ Programet	Numri i puntoreve	Pagat	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione	Shpenzime kapitale	Gjithësejt €
Zyra e Kryetari	160/16027	32	338,521.00	195,000.00	6,000.00	85,000.00		624,521.00
Administrata e përgjithëshme	163/16327	43	352,960.00	410,000.00	27,000.00			789,960.00
Inspekcioni	166/16653	18	194,684.00	180,000.00	9,000.00			383,684.00
Prokurimi	167/16835	12	113,331.00	10,000.00	500.00			123,831.00
Zyra e Kuvendit komunal	169/16927	35	336,452.00	35,000.00				371,452.00
Buxhet dhe financa	175/17527	30	276,352.00	75,000.00	6,000.00			357,352.00
Shërbime Publike,Infrastrukturë dhe banim	180/18187	13	134,134.00	2,200,000.00	270,000.00	565,000.00	2,600,000.00	5,769,134.00
Mbrojtje dhe Shpëtim	180/18431	42	409,620.00	230,000.00	8,500.00		140,000.00	788,120.00
Zyra e komuniteteve	195/19635	7	62,977.00	5,700.00	700.00			69,377.00
Bujqësi dhe Pylltari	470/47027	8	83,191.00	120,000.00	6,000.00	450,000.00	350,000.00	1,009,191.00
Zhvillim Ekonomik	480/48027	13	129,250.00	250,000.00	2,000.00	350,000.00	4,339,720.00	5,070,970.00
Kadastër ,Gjeodezi ,Pronë	650/65335	26	240,694.00	33,000.00	7,000.00		800,000.00	1,080,694.00
Urbanizëm, planifikim dhe mbrojtje të mjedisit	660/66440	20	208,584.00	650,000.00	13,000.00		900,000.00	1,771,584.00
Shëndetësia	730	301	3,706,051.00	1,054,917.00	105,000.00	-	-	4,865,968.00
DSHMS	730/73036	6	56,051.00					56,051.00
QKMF	730/74600	295	3,650,000.00	1,054,917.00	105,000.00			4,809,917.00
QPS	755/75631	16	144,655.00					144,655.00
Shërbimet residenciale	755/75632	10	102,500.00	90,000.00	10,000.00		212,500.00	415,000.00
Kulturë, Rini dhe Sport	850/85027	31	271,665.00	155,000.00	60,000.00	340,000.00		826,665.00
Teatri I Gjilanit	850/85208	22	291,363.00	180,000.00	12,000.00	55,265.00		538,628.00
Arsim dhe shkencë	920	1,723	16,385,681.00	4,057,102.00	208,932.00	350,000.00	400,000.00	21,401,715.00
DKA	920/92135	19	171,025.00	2,222,269.00	4,445.00	350,000.00	400,000.00	3,147,739.00
Arsimi parashkollor dhe qerdhet	920/92730	147	1,232,574.00	353,408.00	38,897.00			1,624,879.00
Arsimi fillor	920/93780	1165	11,182,404.00	864,628.00	110,023.00			12,157,055.00
Arsimi I mesem	920/94980	392	3,799,678.00	616,797.00	55,567.00			4,472,042.00
Gjithësejt €		2,402	23,782,665.00	9,930,719.00	751,632.00	2,195,265.00	9,742,220.00	46,402,501.00

Të punësuarit sipas strukturës gjinore nëpër programe.

Drejtoritë/Programet	Drejtoritë/ Programet	Numri i puntoreve	F	M
Zyra e Kryetari	160/16027	32	17	15
Administrata e përgjithëshme	163/16327	43	18	25
Inspekcioni	166/16653	18	10	8
Prokurimi	167/16835	12	6	6
Zyra e Kuvendit komunal	169/16927	35	12	23
Buxhet dhe financa	175/17527	30	9	21
Shërbime Publike,Infrastrukturë dhe banim	180/18187	13	5	8
Mbrojtje dhe Shpëtim	180/18431	42	2	40
Zyra e komuniteteve	195/19635	7	2	5
Bujqësi dhe Pylltari	470/47027	8	2	6
Zhvillim Ekonomik	480/48027	13	6	7
Kadastër ,Gjeodezi ,Pronë	650/65335	26	14	12
Urbanizëm, planifikim dhe mbrojtje të mjedisit	660/66440	20	10	10
DSHMS	730/73036	6	2	4
QKMF	730/74600	295	214	81
QPS	755/75631	16	12	4
Shërbimet residenciale	755/75632	10	5	5
Kulturë, Rini dhe Sport	850/85027	31	13	18
Teatri I Gjilanit	850/85208	22	6	16
Arsimi dhe shkenca	920/	1723	1,087	636
Gjithësejt €		2,402	1,452	950

Përkatësia gjinore të punësuarve në Komunën e Gjilanit është si në vijim: gjithësejt të punësuar 2402, prej tyre 950 meshkuj dhe 1452 femra. Shprehja në përqindje: 60,45% femra, 39.55% meshkuj.

Analiza e të punësuarve në aspektin gjinor.

Viti	Nr.total I stafit	Nr.total I stafit femra	Nr.total I stafit meshkuj	Paga dhe meditje /Shuma për Femra	Paga dhe meditje /Shuma për Meshkuj
Planifikimi 2023	2484	1378	1101	8,751,129.77	7,198,848.23
Planifikimi 2024	2400	1371	1029	11,200,731.64	8,573,092.36
Planifikimi 2025	2435	1423	1012	12,266,387.04	8,422,559.96
Planifikimi 2026	2402	1452	950	13,992,519.99	9,395,378.01

Niveli I pagave	Nr.total I stafit	Nr.i meshkujve në këtë nivel	Shuma e shpenzuar për meshkuj në këtë nivel	Nr.i femrave në këtë nivel	Shuma e shpenzuar për femrave në këtë nivel
201-400					
401-600	385	221	2,003,170.54	144	1,295,245.15
600+	2037	729	7,392,207.47	1308	12,697,274.84

Viti	Buxheti total I sherbimit/subvencionit të caktuar	Numri total I përfitueseve	Numri total I përfitueseve femra	Numri total I përfitueseve meshkuj	Buxheti për femra	Buxheti për meshkuj
Planifikimi 2023	1,195,000.00	100	75	25	630,000.00	565,000.00
Planifikimi 2024	1,536,340.00	293	205	88	845,670.00	690,670.00
Planifikimi 2025	1,998,279.00	293	205	88	1,068,170.00	930,109.00
Planifikimi 2026	2,488,727.00	488	341	147	1,322,300.00	1,166,427.00

3.5. Politikat e reja

Në aspektin e shpenzimeve, Komuna e Gjilanit për periudhën e ardhshme është e orientuar kryesisht në rritjen e investimeve për infrastrukturë, dhe eficiencës së energjisë në ndërtesat publike.

Nga viti 2024 në kuadër të shpenzimeve kapitale është fillua të realizohen projekte të përzgjedhura nga votimi i qytetarëve.

Rritja e numrit të subvencioneve të drejtorisë së kulturës, rinisë dhe sportit që u ndahen OJQ-ve dhe organizatave të udhëhequra nga gratë në Gjilan gjatë periudhës 2026-2028.

Treguesit:

1. Rritja me 10% e shumes së subvencioneve për OJQ-të dhe organizatat e drejtuara nga gratë për vitet 2026-2028;

2. Rritja e numrit të grave dhe vajzave që marrin pjesë në aktivitete kulturore, rinore dhe sportive të financuara nga komuna 2026-2028;

3. Rritja e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në dëgjimet publike dhe proceset vendimmarrëse lidhur me aktivitetet kulturore, rinore dhe sportive në komunë.

Objektivi i zhvilluar dhe treguesit do të ndihmojnë në matjen e progresit drejt objektivit. Këta tregues do të ndihmojnë në matjen e progresit drejt objektivit të rritjes së subvencioneve të ndara për OJQ-të dhe organizatat e udhëhequra nga gratë në Gjilan.

Treguesi i parë mat rritjen e përqindjes së subvencioneve të akorduara për këto grupe.

Treguesi i dytë fokusohet në rritjen e numrit të grave dhe vajzave që marrin pjesë në aktivitete kulturore, rinore dhe sportive të financuara nga komuna, gjë që ndihmon në sigurimin e qasjes së barabartë të grave në këto programe.

Treguesi i tretë mat pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në proceset vendimmarrëse lidhur me aktivitetet kulturore, rinore dhe sportive në komune, gjë që ndihmon në promovimin e barazisë gjinore në ndarjen e subvencioneve. Duke ndjekur këta tregues, komuna mund të vlerësojë suksesin e përpjekjeve të tyre për të promovuar barazinë gjinore në programet kulturore, rinore dhe sportive.